



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
Ministarstvo Kulture, Omladina i Sporta ~ Ministry of Culture, Youth & Sport

STRATEGJIA KOMBËTARE PËR TRASHËGIMINË KULTURORE 2017-2027

1 PERMBLEDHJA EKZEKUTIVE

Strategjia Kombëtare për Trashëgimi Kulturore 2017-2027 është një strategji gjithëpërfshirëse e Qeverisë së Kosovës në fushën e trashëgimisë kulturore, e cila synon vendosjen e kornizave afatgjata për vizionin dhe ofrimin e zgjidhjeve të bazuara në parimin e qëndrueshmërisë. Ky dokument strategjik synon avancimin e sistemit dhe të mekanizmave për mbrojtjen dhe ruajtjen e trashëgimisë kulturore të Kosovës në përputhje me kornizën ligjore, parimet dhe standardet ndërkombëtare, si dhe mbi bazën e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik, shoqëror dhe kulturor.

Trashëgimia kulturore përcaktohet si shtyllë e rëndësishme e zhvillimit të qëndrueshëm të vendit, që do të arrihet nëpërmjet bashkëpunimit dhe pjesëmarrjes efektive në avansimin e sistemit të mbrojtjes. Në të adresohen aspektet themelore që në mënyrë të drejtpërdrejtë synojnë promovimin e vlerave reale socio-kulturore dhe ekonomike të trashëgimisë kulturore të Republikës së Kosovës, si dhe rritjen e dukshmërisë së vlerave potenciale të saj. Synimet e Strategjisë përmbledhen si në vijim:

[i] Sistemi ligjor dhe institucional i mbrojtjes - në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, ligjeve tjera relevante dhe angazhimeve të Kosovës, si dhe orientimin e Qeverisë së Kosovës karshi Prioriteteve të Partneritetit Evropian dhe anëtarësimit në UNESCO;

[ii] Qasja e integruar në mbrojtje - sipas parimeve dhe trendëve të planifikimit dhe zhvillimit të qëndrueshëm urban, ekonomik, shoqëror dhe kulturor;

[iii] Edukimi, promovimi dhe ndërgjegjësimi qytetar - me qëllim të nxitjes së ndjenjës së identitetit kulturor dhe si burim i frymëzimit dhe inovimit.

Strategjia ndërtohet mbi qëllimet (objektivat) konkrete. Objektivat e Strategjisë burojnë nga synimet më lartë dhe mbi bazën e analizës së përvojave të kaluara, gjendjes aktuale në domenin ligjor, infrastrukturor dhe programor, si dhe të çështjeve në fushën e trashëgimisë kulturore që bëhen subjekt trajtimi në dhjetëvjetëshin vijues në Kosovë.

Objektivi i parë korrespondon me synimin e parë; objektivat 2 dhe 3 burojnë nga synimi i dytë, ndërsa objektivat 4 dhe 5 nga synimi i tretë. Objektivat janë përkufizuar si më poshtë:

1. Avancimi i kornizës ligjore dhe institucionale;

2. Qasja e integruar në mbrojtje të trashëgimisë kulturore, drejt zhvillimit të qëndrueshëm;
3. Përfshirja e trashëgimisë kulturore në planet zhvillimore;
4. Promovimi i trashëgimisë kulturore;
5. Edukimi, aftësimi dhe pjesëmarrja aktive në mbrojtjen e trashëgimisë kulturore.

Procesi i zbatimit të Strategjisë është zhvilluar në periudhë afatgjate (gati një dekadë), nëpërmjet Planifikimit Strategjik të MKRS, planeve të veprimit dhe programeve të hollësishme për trashëgimi kulturore, të cilat janë zbatuar përmes institucioneve publike të trashëgimisë kulturore si dhe së fundi edhe me zbatimin e Planit Strategjik Operacional.

Në proces janë përfshirë akterë të ndryshëm nga nivele relevante ministrore, institucione qendrore dhe lokale, si dhe ato ndërkombëtare, me qëllim të krijimit të sinergjisë së dëshiruar në funksion të përmbushjes së prioriteteve qeveritare.

Është bërë progres i madh në përmbushjen e detyrimeve për zbatimin e strategjisë, ku është përmbushur synimi i parë i strategjisë – *Sistemi ligjor dhe institucional i mbrojtjes*. Në vitin 2022 është bërë avancim i dukshëm i kornizës ligjore dhe institucionale. Në këtë aspekt kemi pasur avancim të theksuar në nxjerrjen e legjislacionit sekondar, të cilat garantojnë bazë të mirë për delegim, funksionim dhe ndarje të përgjegjësive për institucionet publike vartëse të trashëgimisë kulturore, përmes akteve nënligjore të miratuara nga Ministria:

- Rregullore Nr.11/2022 Për inventarizimin dhe procesin e përzgjedhjes së trashëgimisë kulturore për mbrojtje;
- Rregullore Nr.01/2022 Për përcaktimin e perimetrit dhe zonës mbrojtëse të aseve të Trashëgimisë Kulturore dhe politikave për Konservimin dhe zhvillimin e tyre;
- Udhëzimi Administrativ (MKRS) – Për kriteret, kërkesat, rregulla dhe procedurat lidhur me lëshimin, administrimin dhe revokimin e licencave profesionale për persona fizikë dhe juridikë në fushën e trashëgimisë kulturore;

Nxjerrja e legjislacionit sekondarë ka zbrëthyer më tej detyrat dhe përgjegjësitë e deleguara me Ligjin Nr.02-L/088 Për Trashëgimi Kulturore, duke qartësuar deri në detaje për vetë institucionet, mekanizmat ndërlidhës, palët dhe shoqërinë civile detyrat dhe përgjegjësit për mbrojtjen dhe ruajtjen e aseteve të trashëgimisë kulturore.

Progres i madh është arritur me përfshirjen e aseteve të trashëgimisë kulturore nën Mbrojtje të Përhershme, të procedura me 54 dosje të aseteve, të miratuara pesë prej tyre deri më tani. Po ashtu është nxjerrë Lista e Trashëgimisë Kulturore nën Mbrojtje të Përkohshme, që përfshinë edhe ndërtesa/objekte të reja nën mbrojtje.

1. Lista e trashëgimisë kulturore/Mbrojtja e përkohshme 2022/2023 https://ëëë.mkrs-ks.org/repository/docs/Vendim_i_Ministrit_MKRS_per_Mbrojtje_te_Perkohshme_2022-2023.pdf
2. Lista e trashëgimisë kulturore/Mbrojtja e përhershme 2022/2023 <https://kktk.rks.gov.net/Publication/Lajmi/167>

Në vitin 2022, kanë gjetur zbatim Planet e Menaxhimit të miratuara në vitin 2020, të cilat janë plotësuar me Vendimet e Ministrit për Njësinë Menaxhuese të Kalasë së Prizrenit dhe të Komisionit Mbikëqyrës për Zbatimin e Planit të Menaxhimi për Qendrën Historike të Prizrenit.

Në Qershor të vitit 2022 është nxjerrë Lista e Trashëgimisë në rrezik, që shërben bazë për zbatimin e Masave të sigurisë teknike dhe zbatimin e programit: Masa Preventive, Intervenime Emergjente. Kjo listë përmban 308 asete të trashëgimisë kulturore, të cilat janë listuar në bashkëpunim me institucionet publike vartëse të trashëgimisë kulturore.

Po ashtu, hartimi dhe hyrja në fuqi e Procedurës Standarde Operative (PSO) për komisionet shqyrtuese të IKMM-së, IAK dhe QRTK Prizren, ka lehtësuar edhe më teje funksionimin dhe administrimin e kërkesave të palëve ndaj institucioneve publike vartëse të trashëgimisë kulturore.

Progres i madh është bërë po ashtu në përmbushjen e *Qasjes së integruar në mbrojtje*, sipas parimeve dhe trendëve të planifikimit dhe zhvillimit të qëndrueshëm urban, ekonomik, shoqëror dhe kulturorë.

Është punuar në hartimin e raportit për dokumentin e gjendjen aktuale të muzeve “Zhvillimi i muzeve në Kosovë”, i cili trajton muzetë e nivelit qendror dhe lokal në tërë territorin e Republikës së Kosovës. Po ashtu është përgatitur dokumenti për thirrjen publike për ekspozitat në Kullën e Isa Boletinit, Kompleksin e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit dhe Muzeun Etnologjik-Kompleksi Emin Gjiku në Prishtinë.

Përmes thirrjeve publike për mbështetje të OJQ-ve dhe shoqërisë civile kemi përmbushur edhe një objektiv tjetër të strategjisë për trashëgimi kulturore, që lidhet drejtpërdrejtë me *Edukimin, aftësimin dhe pjesëmarrjen aktive në mbrojtjen e trashëgimisë kulturore*. Në kuadër të këtij objekti kemi ndarë bursa për kuadro deficitarë që studiojnë në universitetet ndërkombëtare në programet: bachelor, master dhe doktoratë.

Përmes qasjes së integruar në trashëgiminë kulturore drejt zhvillimit të qëndrueshëm është krijuar mundësia e ruajtjes dhe menaxhimit më efektiv të aseteve të trashëgimisë kulturore, duke siguruar vazhdimin dhe avancimin e programit: Masa Preventive, Intervenime Emergjente, si dhe në vitet e fundit edhe ndërmarrjen e masave teknike të sigurisë dhe nxjerrjen e Listës së Trashëgimisë në rrezik.

2 PROGRESI NË ZBATIMIN E OBJEKTIVAVE TË DOKUMENTIT TË STRATEGJISË

Me dokumentin e Strategjisë Kombëtare për Trashëgimi Kulturore 2017 – 2027, janë trajtuar pesë objektiva të strategjisë, ku në shumicën prej tyre është arritur progres. Reformat e nisura në kuadër të ndarjes dhe delegimit të përgjegjësisë tek institucionet publike vartëse të trashëgimisë kulturore kanë krijuar vazhdimin e zbatimit më të madh të strategjisë.

Gjatë vitit 2022 është përmbushur objektiv i *Avancimit të kornizës ligjore dhe institucionale* (objektivi 1); është siguruar *Qasje e integruar në mbrojtje të trashëgimisë kulturore drejt zhvillimit të qëndrueshëm* (objektivi 2); ka vazhduar procesi i *Promovimit të trashëgimisë kulturore* (objektivi 4) dhe *Edukimi, aftësimi dhe pjesëmarrja aktive në mbrojtjen e trashëgimisë kulturore* (objektivi 5). Ndërsa më pak zbatim ka gjetur *Përfshirja e trashëgimisë kulturore* (objektivi 3), por që ka ndërmarrje për sa i përket nxjerrjes së legjislacionit sekondarë nga ana e Ministrisë për përmbushjen dhe sigurimin e zbatimit të këtij objekti përmes dy dokumenteve:

- Udhëzimin Administrativ për Hartimin e Projekteve të Konservimit dhe Restaurimit dhe Aktivitetet Konservuese të Trashëgimisë Kulturore dhe
- Udhëzimin Administrativ për Konservimin e Integruar.

2.1 PROGRESI KUNDREJT OBJKTIVIT – OBJEKTIVI 1

AVANCIMI I KORNIZËS LIGJORE DHE INSTITUCIONALE

Investimi në institucionet e trashëgimisë kulturore dhe në sistemin e mbrojtjes ligjore mbetet prioritet edhe gjatë periudhës së kësaj strategjie.

Avancimi, plotësimi, harmonizimi dhe zbatimi i legjislacionit – Në këtë kuadër është arritur kompletimi i legjislacionit, harmonizimi i Ligjit dhe akteve ligjore të trashëgimisë kulturore me ligjet tjera të Kosovës; është vazhduar procesi i Përafrimit të vazhdueshëm të legjislacionit për trashëgiminë kulturore me Legjislacionin e BE-së; është garantuar Zbatimi efektiv i legjislacionit dhe politikave për trashëgiminë kulturore; Ndërsa ka ngecur dhe mbetet sfidë Anëtarësimi në organizatat ndërkombëtare.

Resurset buxhetore për përmbushjen e këtij objektivi janë përdorur në tërësi nga Buxheti i Republikës së Kosovës.

2.2 PROGRESI KUNDREJT OBJKTIVIT – (OBJEKTIVI 2)

QASJA E INTEGRUAR NË MBROJTJE TË TRASHËGIMISË KULTURORE, DREJT ZHVILLIMIT TË QËNDRUESHËM

Trashëgimia kulturore bëhet resurs i zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik, shoqëror dhe kulturor nëpërmjet bashkëpunimit ndërinstytucional dhe multisektorial.

Ruajtja dhe menaxhimi efektiv i aseteve të trashëgimisë kulturore si parakusht për zhvillim të qëndrueshëm - Vazhdimi dhe avancimi i programit për intervenime emergjente, duke garantuar të drejtat e pronarëve, poseduesve dhe shfrytëzuesve të pronave kulturore; është vazhduar procesi i *Monitorimit dhe mirëmbajtjes së vazhdueshme e aseteve të trashëgimisë kulturore*, me theks të veçantë të aseteve që janë nën menaxhim të drejtpërdrejtë të Ministrisë apo edhe të institucioneve publike vartëse të trashëgimisë kulturore; është në vazhdim procesi i *Hartimit të Planit të Menaxhimit* për Parkun Arkeologjik Ulpiana dhe është emëruar vendimi për caktimin njësisë menaxhuese për Kalanë e Prizrenit dhe emërimi i Komisionit Mbikëqyrës për Zbatimin e Planit të Menaxhimit për Qendrën Historike të Prizrenit, po ashtu janë në proces edhe hartimet e dy planeve të menaxhimit në bashkëpunim me OSCE, komunat dhe institucionet publike vartëse të trashëgimisë kulturore për Hamamin e Prishtinës dhe Qarshinë e Pejës; është në vazhdim e sipër procesi i *Përmirësimit të qasjes publike dhe promovimi i përdorimeve të qëndrueshme të aseteve të trashëgimisë kulturore*. Mbetet sfidë hartimi i planeve të menaxhimit edhe për asete tjera që janë në menaxhim të drejtpërdrejtë nga MKRS dhe institucionet publike vartëse të Trashëgimisë Kulturore, me qenë se ndërtesat janë të mbrojtura dhe institucionet e zhvillojnë veprimtarinë e tyre në po ato ndërtesa: Muzeu Kombëtar i Kosovës, Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve, Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturore – Gjilan, Prizren, Pejë, Kompleksi Etnologjik Emin Gjiku, Ndërtesa e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit dhe Kompleksi i Kullave të Isa Boletinit në Zveçan.

Resurset buxhetore për përmbushjen e këtij objektivi janë përdorur nga Buxheti i Republikës së Kosovës, Fondet e Bashkimit Evropian – Instrumenti i Para asistencës IPA për projektin Parku Arkeologjik Ulpiana, Revitalizimi i rrugës Marin Barleti dhe Kino Lumbardhi në Prizren, Marrëveshja me UN-Habitat për Programin për Zhvillimin Gjithëpërfshirës/ Aktivitetet e Integruara përmes bashkëfinancimit të ri me Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, për projektet: Prezantimi dhe Interpretimi i Planit për Lokalitetin Arkeologjik në Prizren dhe Studimi i Fizibilitetit për Qendrën Historike në Prishtinë, bashkëpunimi me OSBE, përmes projekteve: Hartimi i Planit të Menaxhimit për Ndërtesën e Hamamit të madh në Prishtinë dhe Plani i Menaxhimit për Qarshinë e Gjatë në Pejë.

2.3 PROGRESI KUNDREJT OBJKTIVIT – (OBJEKTIVI 3)

PËRFSHIRJA E TRASHËGIMISË KULTURORE NË PLANET ZHVILLIMORE

Më pak zbatim ka gjetur *Përfshirja e trashëgimisë kulturore* (objektivi 3), por që ka ndërmarrje për sa i përket nxjerrjes së legjislacionit sekondarë. Vlen të përmendët bashkëpunimi me disa komuna për përfshirjen e aseteve të trashëgimisë kulturore në Hartat Zonale.

Për zbatimin e këtij objektivi deri më tani nuk ka pasur implikime buxhetore.

2.4 PROGRESI KUNDREJT OBJKTIVIT – (OBJEKTIVI 4)

PROMOVIMI I TRASHËGIMISË KULTURORE

Komunikimi dhe promovimi i trashëgimisë kulturore nxjerrë në pah vlerat reale socio- kulturore dhe ekonomike të trashëgimisë kulturore të Kosovës.

Studimi dhe interpretimi i trashëgimisë kulturore - Studimi dhe interpretimi objektiv dhe inkluziv i vlerave socio- kulturore dhe ekonomike të trashëgimisë kulturore të Kosovës; ka vazhduar procesi i Rritjes së numrit të botimeve, guidave, medimeve virtuale, etj. dhe shpërndarja sistematike në vend dhe në rrafshin ndërkombëtar; është aplikuar Rritja e përdorimit të mediave digjitale dhe rrjeteve online për promovim të trashëgimisë kulturore të Kosovës.

Ky objektiv është mbështetur edhe përmes thirrjeve publike për mbështetje të OJQ-ve dhe individëve. Në kuadër të këtij objektivi kemi mbështet kuadro deficitarë që studiojnë në universitetet ndërkombëtare në programet: bachelor, master dhe doktoratë.

Resurset buxhetore për përmbushjen e këtij objektivi janë përdorur në tërësi nga Buxheti i Republikës së Kosovës.

PROJETKE AD HOC – 9 PROJEKTE PËR INDIVID	45,259.00 €
THIRRJA PËR MOBILITETIN – 2 PROJEKTE PËR OJQ	11,860.00 €
THIRRJA PËR MUNDËSI TË BARABARTA – 1 PROJEKT PËR OJQ	10,960.00 €
THIRRJA E PARË PËR ART DHE TRASHËGIMI, PËRFSHIRË DHE ANKESAT – 12 OJQ DHE 4 INDIVID	384,792.34 €
THIRRJA E DYTË PËR ART DHE TRASHËGIMI, PËRFSHIRË DHE ANKESAT – 17 OJQ DHE 4 INDIVID	158,820.00 €
THIRRJA PER NGRITJE TË KAPACITETEVE PROFESIONALE – 4 PERFITUES	39,695.00 €
SHUMA TOTALE PER OJQ	462,692.34 €
SHUMA TOTALE PER INDIVID	80,920.00 €

2.5 PROGRESI KUNDREJT OBJKTIVIT – (OBJEKTIVI 5)

EDUKIMI, AFTËSIMI DHE PJESËMARRJA AKTIVE NË MBROJTJEN E TRASHËGIMISË KULTURORE

Zhvillimi i debatit bashkëkohor në fushën e trashëgimisë kulturore kontribuon në përmirësimin e imazhit të Kosovës.

Përmirësimi i “qasjes për të gjithë” në trashëgiminë kulturore - Promovimi i Strategjisë Kombëtare për Trashëgiminë Kulturore, me qëllim të fuqizimit të debatit publik dhe ndërgjegjësimit lidhur me objektivat e Strategjisë kombëtare; ka vazhduar procesi i Përmirësimit të qasjes intelektuale, fizike dhe virtuale në asetet dhe lokalitetet e trashëgimisë kulturore; përmes thirrjeve publike është

mbështetur Promovimi i përdorimeve alternative të lokaliteteve të trashëgimisë, me qëllim të fuqizimit të lidhjes midis trashëgimisë kulturore dhe arteve; si dhe Promovimi i dijeve tradicionale, transferi i kujtesës kolektive dhe rrëfimeve gojore nga brezi i vjetër tek brezi i ri.

Ky objektivi është përmbushur në tërësi dhe rekomandohet që të vazhdohet me përfshirjen e tij në çdo vit kalendarik.

Resurset buxhetore për përmbushjen e këtij objektivi janë përdorur në tërësi nga Buxheti i Republikës së Kosovës.

3 RREZIQET DHE HAPAT PËR ADRESIMIN E TYRE

Zbatimi i Strategjisë Kombëtare për Trashëgiminë Kulturore 2017-2027 varet në masë të madhe nga bashkëpunimi ndërinstitucional dhe shumë sektorial, nga përfshirja e një numri subjektesh në zbatimin e masave dhe veprimeve, si dhe nga monitorimi i vazhdueshëm i proceseve dhe dinamikave të përcaktuara për çdo orientim strategjik.

Sfidë mbetet mos themelimi i Komitetit për zbatimin e strategjisë. Ministri i MKRS-së me vendim të veçantë do të duhej të përcaktonte themelimin dhe përgjegjësitë e këtij Komiteti (monitorimi i progresit të zbatimit të planeve të veprimit, identifikimi i faktorëve të rrezikut në zbatim dhe të masave lehtësuese, përditësimi konform kërkesave të reja, organizimi i takimeve vjetore me publikun, pjesëtarë të komunitetit të trashëgimisë kulturore dhe palë të interesuara në zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e Strategjisë, etj.), si dhe sistemin e komunikimit dhe përgjegjësitë për raportim dhe monitorim të subjekteve të definuara si institucione ose/dhe grupe ndërinstitucionale, përgjegjëse për zbatimin e objektivave strategjike.

Komiteti i cili do të duhej të themelohej për monitorimin dhe zbatimin e strategjisë, do të adresonte sfidat dhe rreziqet, të cilat lidhen drejtpërdrejtë me:

- Krijimin e sistemit për vlerësim dhe parandalim të rrezikut ndaj trashëgimisë kulturore;
- Krijimi i listës së prioriteteve për intervenim mbi bazën e konsultimeve paraprake, shkallës së rrezikshmërisë, analizën buxhetore për ndërhyrje emergjente ose/dhe preventive dhe mirëmbajtje vjetore;
- Vlerësimi dhe parandalimi i rrezikut për ruajtjen e trashëgimisë kulturore nga efektet e fatkeqësive natyrore dhe kërcënimet e shkaktuara nga veprime njerëzore.

Rekomandohet themelimi i mekanizmit për monitorim dhe zbatim të strategjisë, në mënyrë që të parandalohen rreziqet e lartpërmendura.

Shtojca

Shtojca 1: Raporti i monitorimit të planit të veprimit për vitin 2022. Shtojca të tjera mund të ofrohen për të mbështetur dhe ilustruar informacionin e paraqitur më sipër.

Shtojca 1.

Raporti i monitorimit të planit të veprimit për vitin 2022 - Progresin kundrejt veprimeve për Strategjinë Kombëtar për Trashëgimi Kulturor 2017 - 2027

Fokusi i raportit të planit të veprimit është në përfundimin e veprimeve siç parashihet në planin e veprimit dhe arsyet e vonesave, të cilat jepen në shtyllën "Progresi në zbatim".

Nr.	Objektivat dhe veprimet	Afati i fundit	Burimi i financimit	Institucioni udhëheqës dhe mbështetës	Produkti (Output)	Referenca në dokumente	Progresi në zbatim
I.	Objektivi strategjik:						
I.1	AVANCIMI I KORNIZËS LIGJORE DHE INSTITUCIONALE						
I.1.1.1	Avancimi, harmonizimi dhe zbatimi i legjislacionit	Janar - Dhjetor 2022	Buxheti i Republikës së Kosovës	MKRS dhe institucionet publike vartëse të Trashëgimisë Kulturore	Legjislacioni sekondar: rregullore dhe udhëzime administrative (MKRS)	/	Ka filluar zbatimin në fund të vitit 2022
I.1.1.2	Zhvillimi i institucioneve të trashëgimisë kulturore	Janar – Dhjetor 2022	Buxheti i Republikës së Kosovës	MKRS, institucionet publike vartëse të Trashëgimisë Kulturore dhe donatorët	Lista e TK-së mbrojtja e përhershme, mbrojtja e përkohshme, lista e trashëgimisë në rrezik, lista e masave të sigurisë teknike,	/	Është zbatuar gjatë tërë vitit

					lista e masave preventive, intervenimet emergjente		
I.1.1.3	Zhvillimi i institucioneve të trashëgimisë kulturore	Janar – Dhjetor 2022	Buxheti i Republikës së Kosovës	MKRS dhe institucionet publike vartëse të Trashëgimisë Kulturore	Mbrojtja ruajtja, zhvillimi i muzeve	/	Është zbatuar gjatë tërë vitit
II.1	QASJA E INTEGRUAR NË TRASHËGIMINË KULTURORE, DREJT ZHVILLIMIT TË QËNDRUESHËM						
II.1.1.1	Ruajtja dhe menaxhimi efektiv i aseteve të trashëgimisë kulturore si parakusht për zhvillim të qëndrueshëm	Janar – Dhjetor 2022	Buxheti i Republikës së Kosovës	MKRS dhe institucionet publike vartëse të Trashëgimisë Kulturore	Mbrojtja, ruajtja, planet e menaxhimit	/	Është zbatuar gjatë tërë vitit
II.1.1.2	Përfshirja e trashëgimisë kulturore në agjendën e zhvillimit të qëndrueshëm	Janar – Dhjetor 2022	Buxheti i Republikës së Kosovës	Qeveria e Republikës së Kosovës , MKRS dhe institucionet publike vartëse të Trashëgimisë Kulturore	E përcaktuar prioritet në Planin e Punës së Qeverisë	/	Është zbatuar gjatë tërë vitit

III.1.2.3	Krijimi dhe asociimi në platformat e bashkëpunimit	Janar – Dhjetor 2022	Buxheti i Republikës së Kosovës	MKRS dhe institucionet publike vartëse të Trashëgimisë Kulturore	E përcaktuar me Planin Strategjik Operacional	/	Është zbatuar gjatë tërë vitit
III.1	PËRFSHIRJA E TRASHËGIMISË KULTURORE NË PLANET ZHVILLIMORE						
III.1.1.1	Fuqizimi i konservimit të integruar si koncept fundamental për zhvillim të qëndrueshëm	Janar – Dhjetor 2022	Buxheti i Republikës së Kosovës dhe donatorët	MKRS, institucionet publike vartëse të Trashëgimisë Kulturore, Fondet IPA, Un Habitat	E përcaktuar me Planin Strategjik Operacional	/	Është zbatuar gjatë tërë vitit
III.1.2.1	Përfshirja e trashëgimisë kulturore në politikat dhe dokumentet kombëtare të planifikimit hapësinor	Janar – Dhjetor 2022	Buxheti i Republikës së Kosovës	MKRS dhe institucionet publike vartëse të Trashëgimisë Kulturore	E përcaktuar me Planin Strategjik Operacional	/	Është zbatuar gjatë tërë vitit
III.1.2.3	Përfshirja e trashëgimisë kulturore në dokumentet e planifikimit komunal	Janar – Dhjetor 2022	Buxheti i Republikës së Kosovës	MKRS , institucionet publike vartëse të Trashëgimisë Kulturore dhe komunat	E përcaktuar me Planin Strategjik Operacional	/	Është zbatuar gjatë tërë vitit

IV.1	PROMOVIMI I TRASHËGIMISË KULTURORE						
IV.1.1.1	Studimi dhe interpretimi i trashëgimisë kulturore	Janar – Dhjetor 2022	Buxheti i Republikës së Kosovës	MKRS dhe institucionet publike vartëse të Trashëgimisë Kulturore	E përcaktuar me Planin Strategjik Operacional	/	Është zbatuar gjatë tërë vitit
IV.1.1.2	Zhvillimi i turizmit kulturor në bazë të parimeve të zhvillimit të qëndrueshëm	Janar – Dhjetor 2022	Buxheti i Republikës së Kosovës	MKRS dhe institucionet publike vartëse të Trashëgimisë Kulturore	E përcaktuar me Planin Strategjik Operacional	/	Është zbatuar gjatë tërë vitit
IV.1.1.3	Promovimi i diversitetit kulturor, respektimi dhe mbrojtja e trashëgimisë dhe shprehjes kulturore të komuniteteve të Kosovës	Janar – Dhjetor 2022	Buxheti i Republikës së Kosovës	MKRS, institucionet publike vartëse të Trashëgimisë Kulturore, OJQ-të dhe shoqëria civile	E përcaktuar me Planin Strategjik Operacional	/	Është zbatuar gjatë tërë vitit
V.1	EDUKIMI, AFTËSIMI DHE PJESEMARRJA AKTIVE NË MBROJTJEN E TRASHËGIMISË KULTURORE						

V.1.1.1	Përmirësimi i “qasjes për të gjithë” në trashëgiminë kulturore	Janar – Dhjetor 2022	Buxheti i Republikës së Kosovës	MKRS dhe institucionet publike vartëse të Trashëgimisë Kulturore	E përcaktuar me Planin Strategjik Operacional	/	Është zbatuar gjatë tërë vitit
V.1.1.2	Përmirësimi i kapaciteteve profesionale te punonjësve të trashëgimisë kulturore	Janar – Dhjetor 2022	Buxheti i Republikës së Kosovës	MKRS dhe institucionet publike vartëse të Trashëgimisë Kulturore	Angazhim i stafit të ri	/	Është zbatuar gjatë tërë vitit
V.1.1.3	Edukimi i gjeneratave te reja mbi trashëgiminë kulturore	Janar – Dhjetor 2022	Buxheti i Republikës së Kosovës	MKRS, institucionet publike vartëse të Trashëgimisë Kulturore, OJQ-të, marrëveshjet e bashkëpunimit me universitetet	Angazhim i praktikantëve	/	Është zbatuar gjatë tërë vitit

Shkurt, Prishtinë 2023